



WS Atkins International Limited

TITAN

**PROJEKTI ANTEA
RAPORT STUDIMOR MBI
VLERËSIMIN E SIGURISË
RRUGORE**

PROJEKTI ANTEA

RAPORT STUDIMOR MBI VLERËSIMIN E SIGURISË RRUGORE

NUMRI I PUNES: AV 3049		REFERIMI PËR DOKUMENTIN.:		Road Safety Assessment Study Report _ Rev. 1		
1	Raporti përfundimtar	G. Nellas	K. Souflis	K. Rontiris	K. Rontiris	18.12.07
0	Drafti i parë	G. Nellas	K. Souflis	K. Rontiris	K. Rontiris	24.12.07
		Nisi	Verifikoi	Rishikoi	Autorizoi	Data
Inspekti mi	Qëllimi Përshkrimi	ATKINS				

Kufizimi i Përdorimit të Informacionit

Ky dokument u prodhua nga ËS Atkins International Limited për TITAN CEMENT S.A.

Dokumenti nuk mund të përdoret nga askush për qëllime të tjera, të ndryshme nga ato që specifikohen, pa shprehjen e autorizimit me shkrim nga ËS Atkins International Limited. Cdo lloj detyrimi që do të dalë nga përdorimi i dokumentit nga një palë e tretë, për qëllime që nuk lidhen tërësisht me sa më lart, do të jenë përgjegjësi e vetë palës për të dëmshpërblyer Atkins ndaj cdo lloj pretendimi, kostojë, dëmtimi dhe humbjeje që mund të shfaqen si pasojë e një përdorimi të tillë.

1. HYRJE	1
1.1 Autorizimi dhe Kushtet e Referencës	1
1.2 Objekti i Raportit	2
1.3 Procedura e Raportit	2
2. CËSHTJET DHE SHKALLA E VLERËSIMIT TË RREZIKUT	3
2.1 Segmenti rrugor RrN - VF.....	3
2.1.1 Shtrirja e Përgjithshme	3
2.1.2 Udhëkryqet	3
2.1.3 Përdoruesit e Mjeteve Jo-motorike	5
2.1.4 Shenjat rrugore, vijëzimet e karrexhatës dhe ndricimi	6
2.1.5 Cështje të tjera	7
2.2 Segmenti rrugor KF - VF	8
2.2.1 Shtrirja e Përgjithshme	8
2.2.2 Ura	8
2.2.3 Përdoruesit e Mjeteve Jo-Motorike	9
2.2.4 Shenjat rrugore, vijëzimet e karrexhatës dhe ndricimi	9
3. TABELA e Shkallës së Rrezikut.....	11
4. PLANI I ZBATIMIT	12
SHTOJCA A	13
Dokumentacioni Përmbledhës i Vlerësimit	13
Dokumentacioni Përmbledhës i Vlerësimit	14
Vizatimet Teknike	14
Segmenti rrugor RrN - VF	14
Vizatimet teknike	14
Segmenti rrugor KF -VF	14

TABELA E FIGURAVE

Figure 1	Shtrirja e Autostradës RrN – VF përgjatë Rrugës Ekzistuese	4
Figura 2	Vendodhja e kalimit në nivel të linjës hekurudhore me rrugën..	5
Figura 3	Vendodhja e Zonës së Varrezave dhe Pelegrinazhit	6

1. HYRJE

1.1 Autorizimi dhe Kushtet e Referencës

Ekipi i punes së Atkins mbi Autostradat dhe Transportin ndërmori, me porosi të kompanisë ANTEA CEMENT S.A., një Vlerësim të Sigurisë së rrugëve të propozuara (a) midis Vendodhjes së Fabrikës së Cimentos Titan dhe Rrugës Nacionale Fushë Krujë – Lezhë (RrN - VF) dhe (b) midis Karierës së Flishit dhe Vendodhjes së Fabrikës së Cimentos (KF – VF).

Propozimet e skemave mund të përmbliidhen si më poshtë:

Rruga midis RrN - VF

- Një autostradë me një gjatësi të përgjithshme prej rreth 5,700m midis Vendodhjes së Fabrikës së Cimentos në Borizanë dhe Rrugës Nacionale Fushë Krujë - Lezhë.
- 2 nyja rrugore përgjatë gjatësisë së autostradës, përfshirë ndërprerjen me autostradën dhe linjën hekurudhore.

Rruga midis KF - VF

- Një autostradë me një gjatësi të përgjithshme prej rreth 3,500m midis Vendodhjes së Fabrikës së Cimentos në Burizanë dhe Karierës së Flishit
- Një urë mbi Lumin Droja

Ky raport Vlerësimi mbi Sigurinë Rrugore (VSRr) u krye nga ekipi i mëposhtëm:

- George Nellas, Inxhinier Ndërtimi (i Projektimit të Rrugëve Automobilistike dhe Planifikimit të Transportit)
- Evangelos Kareklas, Inxhinier Ndërtimi (i Projektimit të Rrugëve Automobilistike dhe Trafikut)
- Aristeia Kostakou, Inxhinier Ndërtimi (i Projektimit të Rrugëve Automobilistike)

VSRr u krye në nëntor 2007, në përputhje me Metodologjinë për Vlerësimin mbi Sigurinë Rrugore, me propozim të ekipit të shqyrtimit dhe miratim të kompanisë ANTEA CEMENT S.A. dhe BERZH-KFN. Kjo metodologji trajton procedurat dhe objektin e vlerësimit parashikuar në Manualin e Agjencisë për Projektimin e Rrugëve dhe Urave (MPRrU), Vëllimi 5, Seksioni 2, Pjesa 2 dhe 3, "Vlerësimi mbi Sigurinë Rrugore" Standardi HD 19/03. Si rezultat, ekipi i shqyrtimit ndërmori një Vlerësim të Sigurisë Rrugore, për RrN – VF (Faza 2) dhe KF – VF (Faza 1).

1.2 Objekti i Raportit

Dokumentacioni Përmbledhës i Vlerësimit u krye nga z. Nick Pantazaras, inxhinier ndërtimi dhe përfaqësues i emëruar i kompanisë ANTEA CEMENT S.A. Shtojca A e këtij raporti rendit përmbajtjen e Dokumentacionit Përmbledhës të Vlerësimit.

1.3 Procedura e Raportit

Vlerësimi përmbledh një rishikim të dokumentacionit Përmbledhës të Vlerësimit, projektimet dhe raportet përkatëse teknike, të cilat janë kryer gjatë verës dhe vjeshtës së vitit 2007. Ekipi ka shqyrtuar dhe raportuar vetëm mbi ndërlikimet që sjell siguria rrugore në kushtet e projektimit, sic parashikohen në këto projekte dhe raporte teknike, dhe nuk ka ekzaminuar apo verifikuar, në mënyrë specifike, përputhshmërinë e projekteve me kriteret tjetra.

Cështjet që ngre ky Vlerësim mbi Sigurinë Rrugore detajohen në Seksionin 2, i cili paraqet një listë me rekomandime për t'u marrë në konsideratë gjatë procesit të projektimit dhe zbatimit.

Seksioni 3 paraqet tabelën e Shkallës së Rrezikut (SheRr) dhe Seksioni 4 përfshin planin e zbatimit të masave zbutëse të propozuara.

2. CËSHTJET DHE SHKALLA E VLERËSIMIT TË RREZIKUT

2.1 Segmenti rrugor RrN - VF

2.1.1 Shtrirja e Përgjithshme

RrN-VF 01: Argjinatura (material mbushës)

Vendodhja: Përgjatë segmentit rrugor të propozuar (kryesisht në km 1+920.70, 2+134.57 - 2+160.79, 4+018.90 - 4+218.90, 4+786.15 - 4+790.72, 5+204.64 - 5+247.38 në të dy anët e rrugës)

Përmbledhje: Argjinatura përgjatë rrugës, që mbështetet kryesisht në muret mbajtëse, përbën shqetësim për shkak të ndërlikimeve kritike të incidenteve që mund të rezultojnë në se mjetet e transportit dalin nga karrexhata. Ndonëse bordurat mbrojtëse tregohen në vizatimet teknike të 'kryqëzimeve tipike', nuk dihet ku janë të vendosura saktësisht në rrugë. Shkalla e rrezikut parashikohet e mesme.

Rekomandim: Sigurimi i masave të duhura mbrojtëse për të parandaluar mundësinë e aksidenteve në rastet kur makina del nga karrexhata. Kjo arrihet kryesisht nëpërmjet ngritjes së bordurave mbrojtëse. Ndonëse ato përfshihen në projektim, vendodhjet e tyre nuk përcaktohen qartë në vizatimet teknike.

RrN-VF 02: Hapja e rrugëve

Vendodhja: Gjatë gjithë gjatësisë së segmentit rrugor (kryesisht në km 1+268.44 - 1+294.91, 1+427.70 - 1+454.39, 1+488.21, 3+324.95, 3+517.72 - 3+720.70, 3+788.88 - 3+968.90, 3+993.90 - 4+018.90, 4+293.90 - 4+363.90, 4+937.97, 5+389.97 - 5+669.56)

Përmbledhje: Hapja e rrugëve në terrene kodrinore përbën shqetësim për shkak të rëshqitjes së gurëve nga lartësia apo terrenit të paqëndrueshëm kodrinor. Shkalla e rrezikut parashikohet e lartë.

Rekomandim: Sigurimi i masave të duhura mbrojtëse për të parandaluar mundësinë e aksidenteve në rastet e rrëshqitjes së gurëve nga lartësia apo paqëndrueshmërisë së terrenit kodrinor. Kjo arrihet kryesisht nëpërmjet rrjetave prej teli apo masave të tjera mbrojtëse.

2.1.2 Udhëkryqet

RrN-VF 03: Udhëkryqet me RrN

Vendodhja: Ndërprerja kryesore me RrN në km 0+000 dhe 0+468. Shtrirja e propozuar e rrugës do të ndjekë rrugën e poshtëshënuar në Figurën 1.



Figura 1 Shtirirja e Autostradës RrN – VF përgjatë Rrugës Ekzistuese

Përmbledhja: Kjo ndërprerje me RrN do të përballojë një volum të konsiderueshëm trafiku dhe përqindje të lartë të mjeteve të tonazhit të rëndë. Shkalla e rrezikut parashikohet të jetë e lartë.

Rekomandim: Rishqyrtim dhe përmirësim i kushteve të ndërprerjes, si shenja rrugore (vecanërisht vijëzimi), pllaka fosforeshente, ndricimi dhe sinjalistika.

RrN-VF 04: Ndërprerja me Rrugën Thumanë - Mamurras

Vendodhja: Ndërprerja me rrugën ekzistuese në km 0+468

Përmbledhja: Kjo ndërprerje do të përballojë një përqindje të lartë të mjeteve të tonazhit të rëndë. Shkalla e rrezikut parashikohet të jetë e mesem.

Rekomandim: Rishqyrtim dhe përmirësim i kushteve të ndërprerjes, si shenja rrugore (vecanërisht vijëzimi), pllaka fosforeshente dhe ndricimi.

RrN-VF 05: Kalimi në Nivel i Linjës Hekurudhore

Vendodhja: Kalimi në km 0+364 (shih Figurën 2)



Figura 2 Vendodhja e kalimit në nivel të linjës hekurudhore me rrugën

Përmbledhje: Kjo ndërprerje është projektuar të jetë pa postoblok/pengesa; madje nuk ka as pengesa lëvizëse (si psh barriera). Momentalisht, shkalla e rrezikut është e ulët, por mund të shndërrohet në shkallë të lartë rrezikshmërie me rritjen e trafikut hekurudhor në të ardhmen.

Rekomandim: Rishqyrtim dhe përmirësim i kushteve të kalimit, si barriera, kontroll i automatizuar, shenja rrugore (vecanërisht vijëzimi), pllaka fosforeshente, ndricimi dhe sinjalistika.

2.1.3 Përdoruesit e Mjeteve Jo-motorike

RrN-VF 06: Kryqëzimet dhe vendkalimet e këmbësorëve

Vendodhja: Përgjatë rrugës dhe vecanërisht në pikat e hyrjes / daljes, si zona e varrezave dhe pelegrinazhit në km 1+050 dhe 5+230). Keto paraqiten në figurën 3, si më poshtë:




Figura 3 Vendodhja e Zonës së Varrezave dhe Pelegrinazhit

Përmbledhje: Vizatimi teknik nuk paraqet asnjë kusht lehtësues për këmbësorët. Kjo mund të rezultojë në kushte jo të sigurta të këmbësorëve, vecanërisht në se rruga pritet të mbajë sasi të mëdha të mjeteve të tonazhit të rëndë. Shkalla e rrezikut parashikohet e lartë.

Rekomandim: Projektimi dhe ofrimi i kushteve për këmbësorët në vendodhjen 1+050 dhe 5+230.

RrN-VF 07: Ofrimi i kushteve lehtësuese për qarkullimin e bicikliletave dhe mjeteve që tërhiqen nga kafshët

Vendodhje: Përgjatë rrugës dhe vecanërisht në udhëkryqet dhe zonat me shume hyrje / dalje sic janë zona e varrezave dhe pelegrinazhit (shih vendodhjet më lart).

Përmbledhje: Vizatimet teknike nuk paraqesin asnjë kusht lehtësues për qarkullimin e bicikliletave dhe mjeteve që tërhiqen nga kafshët. Kjo mund të rezultojë në kushte jo të sigurta për këmbësorët vecanërisht në se rruga pritet të mbajë sasi të mëdha të mjeteve të tonazhit të rëndë. Këto mjete do të përdorin të njëjtën rrugë që përdorin edhe këmbësorët, në rast se projektimet janë të duhurat. Duhet të merren masa edhe për lëvizjen e kafshëve (psh.: ndalim i detyrueshëm i kalimit të tyre në rrugë apo krijimi i vendkalimeve të posacme). Shkalla e rrezikut parashikohet e mesme.

Rekomandim: Projektimi dhe ofrimi i kushteve lehtësuese, aty ku shihet e nevojshme.

2.1.4 Shenjat rrugore, vijëzimet e karrexhatës dhe ndricimi

RrN-VF 08: Shenjat dhe vijëzimet

Vendodhja: Përgjatë rrugës dhe vecanërisht në udhëkryqet dhe zonat me shume hyrje / dalje sic janë zona e varrezave dhe pelegrinazhit.

Përmbledhje: Niveli i shenjave dhe vijëzimeve të karrexhatës që shihen në vizatimet teknike, duhet të bëhen më të dukshme për t'i shërbyer përdoruesve jo-motorikë dhe për të informuar e rregulluar më së miri lëvizjen e përdoruesve të mjeteve motorike. Trajtim të vecantë kërkojnë gjithashtu distanca e dallimit të shenjave dhe kontrolli i lëvizjeve lokale. Shkalla e rrezikut parashikohet e ulët.

Rekomandim: Projektimi dhe sigurimi i më shumë shenjave rrugore dhe vijëzimeve të karrexhatës.

RrN-VF 09: Ndricimi

Vendodhja: Gjatë gjithë gjatësisë së rrugës por vecanërisht në zonat e udhëkryqeve.

Përmbledhje: Vizatimet teknike nuk paraqesin ndricim rrugor. Mungesa e ndricimit con detyrimisht në përkeqësimin e kushteve të sigurisë rrugore gjatë natës apo motit të keq, vecanërisht në udhëkryqe, vendkalime dhe hyrje kryesore. Shkalla e rrezikut parashikohet e lartë.

Rekomandim: Projektimi dhe zbatimi i planifikimit të ndricimit rrugor.

2.1.5 Cështje të tjera

RrN-VF 10: Hyrja në vendodhjen e varrezave dhe pelegrinazhit

Vendodhja: 1+050, 5+230

Përmbledhje: Parkimi në buzë të rrugës mund të mos jetë e sigurtë, vecanërisht gjatë gërshetimit me qarkullimin e mjeteve të tonazhit të rëndë. Hyrja në zonë duhet të projektohet, vijëzohet dhe shënohet. Shkalla e rrezikut konsiderohet e lartë.

Rekomandim: Projektimi dhe sigurimi i parkimit dhe rrugës së duhur të kalimit në zonën e pelegrinazhit.

2.2 Segmenti rrugor KF - VF

2.2.1 Shtrirja e Përgjithshme

KF - VF 01: Argjinatura (Materiali Mbushës)

Vendodhja: Përgjatë gjithë rrugës.

Përmbledhje: Argjinatura përgjatë rrugës, një pjesë e së cilës mbështetur kryesisht në muret mbajtëse, përbën shqetësim për shkak të ndërlikimeve kritike të incidenteve që mund të rezultojnë në se mjetet e transportit dalin nga karrexhata. Ndonëse bordurat mbrojtëse tregohen në vizatime teknike të 'kryqëzimeve tipike', nuk dihet ku janë të vendosura saktësisht në rrugë. Shkalla e rrezikut parashikohet e mesme.

Rekomandim: Sigurimi i masave të duhura mbrojtëse për të parandaluar mundësinë e aksidenteve në rastet kur makina del nga karrexhata. Kjo arrihet kryesisht nëpërmjet ngritjes së bordurave mbrojtëse. Ndonëse ato përfshihen në projektim, vendodhjet e tyre nuk përcaktohen qartë në vizatimet teknike.

KF - VF 02: Hapja e rrugëve

Vendodhja: Përgjatë gjithë rrugës.

Përmbledhje: Hapja e rrugëve në terrene kodrinore përbën shqetësim për shkak të rrëshqitjes së gurëve nga lartësia apo terrenit të paqëndrueshëm kodrinor. Shkalla e rrezikut parashikohet e lartë.

Rekomandim: Sigurimi i masave të duhura mbrojtëse për të parandaluar mundësinë e aksidenteve në rastet e rrëshqitjes së gurëve nga lartësia apo paqëndrueshmërisë së terrenit kodrinor. Kjo arrihet kryesisht nëpërmjet rrjetave prej teli apo masave të tjera mbrojtëse.

2.2.2 Ura

KF - VF 03: Ura

Vendodhja: 2+500

Përmbledhje: Kjo urë do t'i shërbejë një sërë automjetesh të tonazhit të rëndë, këmbësorëve, mjeteve që tërhiqen nga kafshët, lëvizjes së kafshëve dhe cdo lloj mjeti tjetër transporti. Kjo llojshmëri e trafikut përbën një çështje shqetësuese për trafikun rrugor pasi në urë nuk paraqitet ndonjë element i vecantë (si psh vendkalime për këmbësorë). Shkalla e rrezikut parashikohet e lartë.

Rekomandim: Sigurimi i shkallës së duhur të sigurisë mbi urë nëpërmjet projektimit dhe zbatimit të kushteve lehtësuese për përdoruesit e tjerë të urës.

2.2.3 Përdoruesit e Mjeteve Jo-Motorike

RrN - VF 04: Kryqëzimet dhe vendkalimet e këmbësorëve

Vendodhja: Përgjatë rrugës e vecanërisht tek ura.

Përmbledhja: Vizatimet teknike nuk paraqesin asnjë kusht lehtësues për këmbësorët. Kjo mund të rezultojë në kushte jo të sigurta për këmbësorët, vecanërisht meqenëse rruga pritët të mbajë fluks të madh të mjeteve të tonazhit të rëndë. Shkalla e rrezikut parashikohet e lartë.

Rekomandimi: Aty ku shihet e nevojshme të projektohen e të ofrohen kushte lehtësuese për këmbësorët.

RrN - VF 05: Ofrimi i kushteve lehtësuese për qarkullimin e bicikliletave dhe mjeteve që tërhiqen nga kafshët

Vendodhja: Përgjatë rrugës dhe vecanërisht në urë.

Përmbledhje: Vizatimet teknike nuk paraqesin asnjë kusht lehtësues për qarkullimin e bicikliletave dhe mjeteve që tërhiqen nga kafshët. Kjo mund të rezultojë në kushte jo të sigurta për këmbësorët vecanërisht në se rruga pritët të mbajë sasi të mëdha të mjeteve të tonazhit të rëndë. Këto mjete do të përdorin të njëjtën rrugë që përdorin edhe këmbësorët, në rast se projektimet janë të duhurat. Duhet të merren masa edhe për lëvizjen e kafshëve (dmth ndalim i detyrueshëm i kalimit të tyre në rrugë apo krijimi i vendkalimeve të posacme). Shkalla e rrezikut parashikohet e mesme.

Rekomandim: Projektimi dhe ofrimi i kushteve të të përshtatshme lehtësuese, vecanërisht në vendodhjen e urës.

2.2.4 Shenjat rrugore, vijëzimet e karrexhatës dhe ndricimi

NH-PS 06: Shenjat dhe vijëzimet

Vendodhja: Përgjatë rrugës

Përmbledhje: Niveli i shenjave dhe vijëzimeve të karrexhatës që shihen në vizatimet teknike, duhet të bëhen më të dukshme për t'i shërbyer përdoruesve të mjeteve jo-motorike dhe për të informuar e rregulluar më së miri lëvizjen e përdoruesve të mjeteve motorike. Trajtim të vecantë kërkojnë gjithashtu distanca e dallimit të shenjave dhe kontrolli i lëvizjeve lokale. Shkalla e rrezikut parashikohet e mesme.

Rekomandim: Projektimi dhe sigurimi i më shumë shenjave rrugore dhe vijëzimeve të karrexhatës.

NH-PS 07: Ndricimi

Vendodhja: Gjatë gjithë gjatësisë së rrugës por vecanërisht në vendodhjen e urës.

Përmbledhje: Vizatimet teknike nuk paraqesin ndricim rrugor. Mungesa e ndricimit con detyrimisht në përkeqësimin e kushteve të sigurisë rrugore gjatë natës apo motit të keq, vecanërisht në vendodhjen e urës. Shkalla e rrezikut parashikohet e ulët.

Rekomandim: Projektimi dhe zbatimi i ndricimit rrugor, në se është e nevojshme.

3. TABELA e Shkallës së Rrezikut

Tabela e mëposhtme përmbledh parashikimet e shkallës së rrezikut sipas segmenteve rrugore dhe çështjet e identifikuara sic vlerësohen në Seksionin 2.

Kodifikimi i çështjes	SheRr		
	I ulët	I mesëm	I lartë
RrN – VF 01		•	
RrN – VF 02			•
RrN – VF 03			•
RrN – VF 04		•	
RrN – VF 05	•		
RrN – VF 06			•
RrN – VF 07		•	
RrN – VF 08	•		
RrN – VF 09			•
RrN – VF 10			•
KF – VF 01		•	
KF – VF 02			•
KF – VF 03			•
KF – VF 04			•
KF – VF 05		•	
KF – VF 06		•	
KF – VF 07	•		

4. PLANI I ZBATIMIT

Zbatimi i planeve të ndërtimit të rrugëve të fabrikës (segmentet rrugore RrN – VF dhe KF – VF) është pajisur me lejet e nevojshme nga organet përgjegjëse shqiptare. Sidoqoftë, rekomandimet që paraqiten në këtë raport – të miratuar më së fundi nga autoritetet shqiptare – duhet të projektohen e zbatohen para fillimit të funksionimit të rrugëve të fabrikës, e më pas të monitorohen. Përjashtim nga sa më sipër bën automatizimi i kontrollit të kalimeve në nivel të linjës hekurudhore e cila duhet të zbatohet kur Hekurudhat Shqiptare të kenë trafik të mjaftueshëm për të garantuar një kontroll të tillë. Deri atëherë, do të mjaftojë kontrolli manual me anë të postobloqeve. Gjithashtu, vendosja e shenjave udhëtrëguese në kryqëzimet rrugore lidhet me politikat e përgjithshme të manaxhimit të trafikut nga autoritetet përgjegjëse, psh.: autoriteti përgjegjës i rrugëve automobilistike nacionale mund të mos pranojë funksionimin e një pjese të sinjalistikës në rrugë automobilistike pa këto shenja udhëtrëguese.

Për më tepër, ndërtimi i zonave të vendpushimeve të automjeteve mund të zbatohet nga ANTEA vetëm në se autoritetet shqiptare japin token e nevojshme për ndërtimin e tyre.

Sic parashikohet në Manualin e Agjencisë për Projektimin e Rrugëve dhe Urave (MPRRU), Vëllimi 5, Seksioni 2, Pjesa 2 dhe 3, “Vlerësimi mbi Sigurinë Rrugore” Standardi HD 19/03, kërkohet zbatimi i dy auditeve të tjera mbi sigurinë rrugore: Faza e tretë e vlerësimit duhet të kryhet gjatë zbatimit dhe faza e katërt duhet të kryhet gjatë shfrytëzimit të segmenteve rrugore.

Siguria rrugore ka nevojë për monitorim të rregullt (në intervale 5 vjeçare) duke shfrytëzuar statistikën mbi aksidentet, grumbulluar nga autoritetet përgjegjëse në zonën përreth, si policia e trafikut dhe spitalet. Kjo analizë mund të kryhet nga ANTEA vetëm në se këto autoritete lejojnë aksesin në të dhënat përkatëse. Në rast se të dhënat statistikore identifikojnë “njolla të errëta”, duhet të projektohen e zbatohen masat përkatëse zbutëse. Efektet e tyre do t'i nënshtrihen vlerësimeve të mëtejshme të sigurisë rrugore.

SHTOJCA A

Dokumentacioni Përmbledhës i Vlerësimit

Dokumentacioni Përmbledhës i Vlerësimit

Vizatimet Teknike

Segmenti rrugor RrN - VF

1. Planimetria e shtrirjes horizontale të rrugës **02 BR DD Plan-Final**
2. Zonë me trafik të kufizuar. **02 BR DD Plan-Final/187 BR-DD Harta e përvetësimit të tokës.**
3. Prerje vertikale. **16 BR DD Seksionet gjatësore – Përfundimtare.**
4. Kryqëzime në intervale të rregullta. **49 BR DD Kryqëzimet-Përfundimtare.**
5. Vendodhjet dhe vizatimet teknike të ndërprerjeve. **26 BR-DD Ndërprerjet me rrugët ekzistuese.**
6. Të dhëna gjeometrike të projektimit të rrugëve, si kurrizet rrugore, gradienti gjatësor dhe tërthor, kufizimi i shpejtësive maksimale të lejueshme, distancat e shikimit, etj. **BR-DD raporti i Projekt Zbatimit.**
7. Shenjat, vijëzimet dhe ndricimi rrugor, duke përfshirë:
 - a. Shenjat rrugore vertikale **42 BR-DD Shenjat dhe vijëzimet rrugore**
 - i. Vijëzimet rrugore horizontale **42 BR-DD Shenjat dhe vijëzimet rrugore**
8. Bordura mbrojtëse. **41 BR-DD Bordura mbrojtëse H4/24 BR-DD kryqëzime tipike**
9. Standardet & rregulloret e shfrytëzuara për projektimin e rrugës. **Standarde Italiane CNR/AASHTO**

Vizatimet teknike

Segmenti rrugor KF -VF

1. Planimetria e shtrirjes horizontale të rrugës **Horizontal_Plan.dwg**
2. Zonë me trafik të kufizuar. **Inventar i Shpronësimit.dwg**
3. Prerje vertikale. **Profile.dwg**
4. Kryqëzime në intervale të rregullta. **Kryqëzime.dëg(6 skedarë)**
5. Vendodhjet dhe vizatimet teknike të ndërprerjeve: **Shtresat_e_Rrugës.dwg, Kanale ujore nënrrugore_800-1000.dwg, Mure_mbajtëse.dwg, Struktura për përforcimin e shtresave sipërfaqësore.dwg**
6. Të dhëna gjeometrike të projektimit të rrugëve, si kurrizet rrugore, gradienti gjatësor dhe tërthor, kufizimi i shpejtësive maksimale të lejueshme, distancat e shikimit, etj. **Plan_Horizontal.dwg, Profile.dwg**
7. Shenjat rrugore, vijëzimet dhe ndricimi, përfshirë **Shenja_Rrugore.dwg**
8. Standardet & rregulloret e shfrytëzuara për projektimin e rrugës: **Projekt-Kusht per Projektimin e Rrugeve Automobilistike, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugeve, Tiranë, 2004**